



DITARI JAVOR

08 - 14 Prill

VIZITA ZYRTARE NË GJERMANI

Takim zyrtar me Ministren e Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, znj. Katarina Barley, Sekretarin Parlamentar të Shtetit në Ministrinë e Drejtësisë, z. Christian Lange dhe Sekretarin Parlamentar të Shtetit, në Ministrinë e Brendëshme Federale, z. Stefan Mayer. Takim zyrtar zhvillova dhe me Florian Hahn, anëtar i Komitetit për Çështjet Europiane si dhe i Komitetit për Punët e Jashtme. Fokusi i takimeve ishte promovimi dhe prezantimi i arritjeve të Shqipërisë për Reformën në Drejtësi, ngritjen dhe funksionimin e organeve të reja, si dhe ngritjen e SPAK. Nga znj. Barley, u theksua se Reforma në Drejtësi është pritur shumë mirë në Gjermani dhe vendet e tjera të BE-së. Z. Hahn u shpreh se Parlamenti është rruga e duhur për të garantuar stabilitetin dhe demokracinë në vend. Z. Mayeri, garantoj nga ana e tij se qeveria gjermane do të vazhdoj të mbështesë Shqipërinë me anë të projektit të binjakëzimit për të rritur më tej njohjen dhe perceptimin e publikut ndaj masave të marra në luftën kundër korrupsionit. Z. Mayer gjithashtu nxiti vijimin e proceseve reformuese të ndërmarra në funksion të procesit të anëtarimit në BE, duke theksuar rolin e Shqipërisë si një nga shtyllat kryesore në Ballkanin Perëndimor. Z. Lange, u shpreh se tashmë Reforma në Drejtësi nuk ka më kthim mbrapa dhe duhet të çohet deri në fund, pasi është e rëndësishme që Shqipëria jetë një vend sa më i sigurt dhe me stabilitet.

INTERPELANCA QYTETARE ME PUNONJËSIT E SISTEMIT PENITENCIAR

Interpelancë me ministren e Drejtësisë, kërkuar në platformën e bashkëqeverisjes shqiperiaqeduam.al, mbi çështjen e trajtimit financiar si dhe të transferimeve. Nga data 1 Prill, shtesa mbi pagë që përfitojnë të gjithë punonjësit e Policisë së burgjeve është në masën 7 %. Nga data 4 Janar, asnjë punonjës i policisë së burgjeve nuk do të transferohet me shërbim mbi 45 km larg vendbanimit të tyre.

TASK FORCA ANTIKORRUPSION

Task Forca Antikorrupsion rekomandoi 9 masa disiplinore në Qendrën Kombëtare të Cilsësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, Tiranë.

PREZANTIMI I PORTALIT "ARKIVA ELEKTRONIKE E AKTEVE"

QBZ prezanton portalin më të ri për publikun, "Arkiva Elektronike e Akteve", një konceptim bashkëkohor dhe funksional. Portali siguron akses më të mirë të publikut në informacionin ligjor, duke kontribuar në përafrimin e Shqipërisë me Komunitetin Europian në fushën e publikimi të legjislacionit.

KOMISIONI KOMBËTAR I INTEGRIMIT

Raportimi i Rezultateve të zbatimit të Reformës në Drejtësi. Këshilli i Lartë Gjyqsor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kanë filuar procedurat për ngritjen e SPAK dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjykata Kushtetuese ringrihet brenda disa muajve.

FJALA E MBAJTUR NË KUVEND

...Reforma në Drejtësi është një nga reformat më të thella shtet-formuese që ka bërë Shqipëria gjatë viteve të pluralizmit. Pavarësisht kundërshtarëve dhe atyre që tjerrin skenarë ogurzi për ta bllokuar, Reforma në Drejtësi, po ecën përpara, e pandikuar, duke provuar në mënyrë të përsëritur se kjo maxhorancë kërkon të instalojë për herë të parë në Shqipëri, një sistem drejtësie që nuk varet nga politika, por që ka forcën të zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme...